



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1629/ 6 prot

Datë 06.08.2026

V E N D I M
Nr. 941/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.08.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumentave të tenderit në procedurën e prokurimit, “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-85806-05-15-2026, me objekt: “Blerje Pajisje Mjekësore dhe Materiale Konsumi për Trajtimin Invaziv të Stenozave (Ngushtimeve) të Kalçifikuara të Arterieve Koronare”, me fond limit 45,239,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 17.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KONEX” me NIPT L71417022J dhe adresë: *Rr. Jordan Misja, Kati 2, Njesia 1, Z.k 8830, Njesia Bashkiake nr 9, Tirane*
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara me adresë: *Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.05.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-85806-05-15-2026, me objekt: “Blerje Pajisje Mjekësore dhe Materiale Konsumi për Trajtimin Invaziv të Stenozave (Ngushtimeve) të Kalçifikuara të Arterieve Koronare”, me fond limit 45,239,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 17.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 25.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me numër

A/2026/6713 dhe nr.1629/2026 prot., datë 25.05.2026, i operatorit ekonomik “Konex” SHPK duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

II.4. Me shkresën nr. 2391/6 prot., datë 28.05.2026 protokolluar me tonën me nr. 1629/1 prot., datë 29.05.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin e ndërmjetëm ne nr. 2391/5 prot., datë 28.05.2026 “Vendim i ndërmjetëm për verifikime pranë organeve të tjera, K.SH.A 85/2026” përmes të cilit njofton se ka vendosur ndërprerjen e afatit 5-ditor të vendimmarrjes deri në marrjen e informacionit nga Spitali Rajonal Shkodër mbi rishqyrtimin e specifikimeve teknike objekt ankese pasi sipas informacionit ky i fundit në cilësinë e përfituesit të mallit ka hartuar specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.5. Me shkresën nr. 2391/6 prot., datë 28.05.2026 protokolluar me tonën me nr. 1629/1 prot., datë 29.05.2026 autoriteti kontraktor i ka njoftuar KPP vendimin e KSHA 85/2026 “Vendim i ndërmjetëm për verifikime pranë organeve të tjera” përmes të cilit bën me dije se i ka kërkuar qendrës Spitalor Uniersitare “Nënë Tereza”, Tiranë në cilësinë e përfituesit të mallit, rishqyrtimin e specifikimeve teknike përkundrejt pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues dukembajtur në konsideratë parimet e LPP-së dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

II.6. Me shkresën nr. 2391/11 prot., datë 26.06.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraaqitur nga operatori ekonomik “KONEX” SHPK lidhur me dokumentet e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. REF-85806-05-15-2026, me objekt “Blerje Pajisje Mjekësore dhe Materiale Konsumi për Trajtimin Invaziv të Stenozave (Ngushtimeve) të Kalçifikuara të Arterieve Koronare” protokolluar me tonën me nr. 1629/2 prot., datë 29.06.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin e KSHA nr. 104/2026 për shqyrtimin e ankesës ku rezulton se ka vendosur pranimin pjesërisht të saj dhe propozimin e anulimit të procedurës së prokurimit konkretisht duke argumentuar:

II Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit si dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE,

ARSYETON:

II.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit "KONEX" shpk mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, konkretisht Shtojca 6 (Formulari i Specifikimeve teknike), KSHA arsyeton se:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 6, Formulari i Specifikimeve Teknike, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se:

"Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për

të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet Teknike:

- Ky objekt prokurimi përfshin dhënie në huapërdorje pranë AK, të një pajisje mjekësore për atherektomi rrotulluese aktive. Specifikimet teknike të pajisjeve janë specifikimet minimale që duhet të plotësojnë këto pajisje. Janë të mirëpritura pajisje me specifikime më të mira. Për pajisjet në përdorim, duhet që:
 - Të gjitha pajisjet dhe softëare përkatës duhet të jenë të certifikuar CE dhe FDA
 - Të gjitha pajisjet e mëposhtme mjekësore, pjesët përbërëse dhe aksesoret e tyre duhet të jenë të reja, të prodhuara jo më shumë se 1 (një) vit më parë
 - Të gjithë pajisjet duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, manual teknikë, etj
 - Për të gjitha pajisjet duhet të kryhen trajnimet përkatëse për përdorimin e tyre.
 - Garancia e pajisjeve të jetë jo më pak se 1 (një) vit

1. Pajisja / Pajisjet për atherektomi rrotulluese aktive

- Të jetë pajisje e lëvizshme për përdorim për atherektomi rrotulluese aktive e përdorshme për Arteriet Koronare. Sistemi duhet të jetë i përpunueshëm me materialet e konsumit të kërkuara për atherektominë.
- Pajisja duhet të përfshijë njësinë e kontrollit, ekranin për monitorimin e shpejtësisë së rrotullimit dhe kohëzgjatjes së ndërhyrjes.
- Duhet të jetë e pajisur me rrotull komandimi për shpejtësinë rrotulluese të frezes. Portat hyrëse të pajisjes përfshijnë furnizimin me energji nga rrjeti elektrik standart Shqiptar (230V – 50Hz AC) dhe furnizimin me ajër të kompresuar ose Azot (6 – 7 atm).

- Shpejtësia e rrotullimit që mundëson pajisja duhet të jetë 60.000 – 200.000 ose më shumë rrotullime në minutë / RPM.
- Portat dalëse duhet të përfshijnë lidhjen pneumatike me frezën e atherektomisë dhe lidhjet elektronike dhe optike për monitorimin e rrotullimit të frezës.
- Të ketë suport me rrota për montimin e njësisë së kontrollit.
- Të ketë rregullator presioni për lidhje me bombul për gazin e kompresuar ose për lidhjen me rrjetin qendror të gazeve spitalore.
- Të përfshihen të gjithë konektorët elektrikë dhe pneumatikë të nevojshëm për funksionimin e pajisjes.
- Seti i atherektomisë duhet të disponojë lidhjet e pershtatshme elektrike dhe pneumatike me njësinë e kontrollit të atherektomisë.
- Të ketë / kenë provën e përdorimit të mëparshëm në Kabinete Hemodinamike në shtetet e EU dhe / ose USA (jo pajisje / softëare eksperimentale ose në testim).
- Të ketë / kenë opsionin e komandimit nga një operator i vetëm (kontrollor freze / modul komandimi në tavolinën e pacientit në Kabinetin e Hemodinamikës).
- Pajisja do t'i ofrohet QSU "Nënë Tereza" me sistem huazimi përgjatë gjithë periudhës së kontratës. Furnitori merr përsipër riparimin / zëvendësimin e pajisjes në rast difekti / problematike. Furnitori duhet të garantojë suportin teknik dhe mirëmbajtjen në rast difekti / problemi për të mos penguar vijueshmërinë e punës.
- Furnitori duhet të vlerësojë paraprakisht standartet teknike të kabinetit të Hemodinamikës (lidhjet hidraulike – pneumatike / lidhjet elektrike) dhe të garantojë përputhshmërinë e pajisjes me kabinetin e Hemodinamikës.

2. Frezë me kateter (me një përdorim) për atherektomi rrotulluese aktive.

Set steril me një përdorim që përdoret për atherektomi rrotulluese aktive. Përfshihet freza (Diametër 1.25mm – 2.0mm) me kateter me gjatësi 135 – 150 cm. Seti i atherektomisë duhet të disponojë lidhjet e pershtatshme elektrike dhe pneumatike me njësinë e kontrollit të atherektomisë.

Të jetë e pajisur me mekanizëm sigurie për çaktivizimin e rrotullimit në rast keqfunksionimi.

Kontrollori i frezës përfshin dorezën e avancimit, butonin e aktivizimit dhe frenimit.

3. Gidë e pershtatshme për sistemin e atherektomisë aktive rrotulluese së bashku me torquer përkatës

- Guida specifike Atherektomie Rrotulluese me bërthamë Platini.
- Të ofrohet në të dyja opsionet Floppy / Extra Support
- Diametri i majës 0.014inch / kompatibilitet me frezën e atherektomisë rrotulluese aktive
- Të ofrohet me gjatësi $\geq 330\text{cm}$
- Të ofrohet sëbashku me torquer përkatës

4. Mikrokateter

Të ofrohet me:

- Profili i hyrjes: $\leq 1.5\text{ Fr.}$
- Profili i kalimit: 2.0 – 2.5 Fr.
- Përputhshmëria e gidës: 0.014 inch.



- Markues Distal radio-opak.
- Veshje hidrofilike në ≥ 50 cm distalë.
- Gjatësia e punës: dy opsione, 130 – 140cm dhe 145 – 155 cm.

5. Kateter drejtues për zgjatim

Të ofrohet me:

- Gjatesia e zgjatimit: 20 – 30 cm dhe 35 – 45 cm.
- Gjatesia e punës: 140 – 160cm.
- Marker Distal radio-opak.
- Veshje hidrofilike.
- Të ofrohet në 3 diametra. 6F – 7F – 8F.

6. Balon prerës për leziona të forta

Të ofrohet me:

- Balon me presion të ulët (presion nominal $< 8\text{ATM}$).
- I pajisur me 3 – 4 pjesë prerëse (Aterotoma) për zgjerimin e lezioneve të forta.
- Gjatësia e kateterit të balonit 100 – 120cm.
- Pajisur me veshje hidrofilike dhe me dy markues.
- I kalueshëm në gidë $\geq 5\text{F}$
- Kompatibël me telat (guideëire) standart 0.014 inch

7. Introduktor (sheath) 8F

- Introduktor (sheath) 8F, set komplet që përfshin introduktorin, dilatatorin, gidën dhe agen e punksonit.
- Gjatësi 9 – 40 cm.
- Kompatibël me telat (guideëire) standart 0.035 - 0.038 inch.

8. Kateter gidë 8F

- Kateter gidë 7F - 8F (Kompatibël me procedura atherektomie rrotulluese)
- Gjatësia 80 – 100 cm.
- Majë atraumatike.
- Veshje hidrofilike.
- Të ofrohet me kurbat më të përdorshme (JL / EBU ose ekuivalent / JR / AL & AR) me madhësi të ndryshme kurbe.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PERGJITHESHME

- Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e prodhimit

- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull si dhe kërkesat bazë të vendosjes në treg të pajisjeve mjekësore (për pajisjen në huapërdorje).

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Në procesverbalin "PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM" mbajtur më datë 15.05.2026 si dhe publikuar në SPE, Autoriteti Kontraktor, ka argumentuar Specifikimet Teknike për objektin e prokurimit si më poshtë:

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP:

"38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë" si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", "për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara."

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, përcjellë me shkresën Nr.152/10 prot dt 12.03.2026 dhe marre me Nr 1307 prot datë 17.03.2026 pranë OBP-së, në përputhje me ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Në Nenin 2 "Qëllimi" të Ligjit Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".

Në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të LPP-së Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën".

Në Nenin 4 "Përkufizime" të LPP-së Nr. 162/2021 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), pika 38, përkufizohet nocioni "Specifikime teknike" si më poshtë vijon:

"38. "Specifikime teknike" janë:

a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira;

b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në

secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të LPP-së Nr. 162/2021 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Në Nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane."

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni I, Neni 15, pika 3, gërma "b" parashikohet se:

"3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;

- grafikun e lëvrimit;

- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit."

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 2, parashikohet se:

"2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme

përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentet e tenderit, procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për këtë procedurë prokurimi, të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik si dhe ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimes "KONEX" shpk arsyeton se:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror e krijuar me VKM Nr. 531, datë 07.09.2023 *"Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe institucioneve të varësisë."* (i ndryshuar). Në pikën 5 të VKM-së Nr. 531, datë 07.09.2023 (e ndryshuar) citohet se: *"OBP" sh.a., është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimeve për mallra, punë, shërbime, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur me vendim të Këshillit të Ministrave është përcaktuar ndryshe."*

Në lidhje me procedurën objekt ankimit, theksojmë se Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, ka deleguar në emër të OBP sh.a të drejtën për të prokuruar kontratën e mallrave me objekt: *"Blerje Pajisje Mjekësore dhe Materiale Konsumi për Trajtimin Invaaziv të Stenozave (Ngushtimeve) të Kalçifikuara të Arterieve Koronare"* në përputhje dhe në harmoni me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi, konkretisht me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 67.

Në VKM Nr. 531, datë 07.09.2023 *"Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe institucioneve të varësisë."* (i ndryshuar), në pikën 13 dhe pikën 13.1 citohet se:

"13. Autoritetet/entet kontraktore duhet t'i dërgojnë OBP sh.a., si organ qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe të dhëna për fondin përkatës për mallrat e shërbimet përkatëse, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga detajimi/rialokimi i buxhetit.

13/1. Autoritetet/entet kontraktore paraqesin kërkesën për prokurim në formë shkresore dhe elektronike, në të cilën bashkëlidhin në formën e duhur të dhënat e domosdoshme teknike dhe sasiore që janë të nevojshme për procedurën, objekt prokurimi, duke përfshirë:

a) përshkrimin/emërtesën e objektit të prokurimit, i cili të përputhet me zërin përkatës në regjistrin e parashikimit;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës (pa TVSH) dhe mënyrën e përlllogaritjes, fondi limit, në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimet publike dhe rregullave të prokurimeve publike, shoqëruar me dokumentacionin provues të këtij procesi;

c) sasinë e mallrave/shërbimeve, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave/shërbimeve;

ç) specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, projektin apo oponencën teknike, nëse është rasti, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme referuar parashikimeve konkrete të ligjit për prokurimet publike dhe rregullave të prokurimeve publike, të shoqëruar me procesverbal argumentues;

d) preventivin/at e punimeve, nëse është rasti, projektet teknike, grafikun e zbatimit të punimeve, i cili të përfshijë fazat, afatet e realizimit të punëve, vendin e realizimit të kontratës/furnizimit/dorëzimit të mallit/shërbimit."

Për sa më lart, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, në kërkesën për prokurim paraqitur pranë OBP sh.a në lidhje me objektin e prokurimit *"Blerje Pajisje Mjekësore dhe Materiale Konsumi për Trajtimin Invaaziv të Stenozave (Ngushtimeve) të Kalçifikuara të Arterieve Koronare"*, ndër të tjera ka paraqitur dhe të dhënat teknike në lidhje me specifikimet teknike, të cilat janë implementuar në DST, Shtojca 6.

Ndodhur në kushtet ku pretendimet e Operatorit ekonomik ankimues (të pasqyruara në Formularin e ankesës) lidhen në mënyrë direkte me Specifikimet teknike, KSHA nëpërmjet shkresës me Nr. 2391/7 Prot., datë 28.05.2026, iu drejtua Autoritetit Kontraktor Përfitues, konkretisht Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, për rishikimin e specifikimeve teknike, sipas pretendimeve të ngritura nga ankimuesi duke mbajtur në konsideratë parimet e LPP-së si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nga korrespondenca zyrtare e OBP sha me Autoritetin Kontraktor Përfitues, ky i fundit nëpërmjet shkresës me Nr. 152/22 Prot. datë 10.06.2026 (regjistruar në OBP sha me Nr. 2391/8 Prot. datë 15.06.2026) ka argumentuar si më poshtë vijon:

Vlerësojmë se marka CE dhe miratimi nga FDA dëshmojnë se një pajisje mjekësore përmbush kërkesat rregullatore dhe mund të tregtohet ligjërisht. Megjithatë, autorizimi për shpërndarje tregtare, edhe pse është një kusht i domosdoshëm, nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për adoptimin e teknologjive me risk të lartë në një qendër universitare kardiovaskulare me volum dhe kompleksitet të lartë, sikundër është QSUNT.

Një laborator universitar i kardiologjisë që operon 24 orë në ditë dhe trajton një numër të madh pacientësh akutë dhe kompleksë, kërkon jo vetëm përpunshmëri rregullatore, por edhe prova të pjekurisë klinike, besueshmërisë operacionale dhe performancës së qendrueshme në kushte reale.

Në Shërbimin e Kardiologjisë së QSUT Nënë Tereza, realizohet një volum shumë i lartë procedurash invazive, me rreth 3.000 angioplastika në vit, një pjesë e rëndësishme e tyre në pacientë me shkallë kompleksiteti mjaft të lartë. Ky numër dhe ky kompleksitet e bën unike qendrën tonë në shkallë vendi dhe të krahasueshme me qendrat më të mëdha në vendet e tjera. Për shkak të këtij kompleksiteti, një numër i konsiderueshëm pacientësh kanë nevojë për procedura speciale të realizuara me teknologji të avancuar, siç është aterektomia rotacionale e cila ka përdorim të posaçëm për trajtimin e arterieve koronare me nivel të lartë kalçifikimi. Kjo procedurë ka efikasitet të lartë por shoqërohet edhe me një shkallë rreziku më të lartë për komplikacione fatale ose jo fatale, për shkak të kompleksitetit të sëmundjes për të cilën përdoret. Bazuar në aktivitetin tonë, rreth 10-15% e pacientëve të cilët trajtohen me angioplastikë kanë nevojë për përdorimin e aterektomisë rotacionale, pra rreth 300-400 pacientë në vit, çka përbën një numër shumë të madh edhe për qendra të mëdha në vende të tjera evropiane.

Evidenca e përdorimit rutinë klinik, jashtë kuadrit të studimeve klinike apo eksperimentale, në qendra të konsoliduara terciare është e rëndësishme për arsyet e mëposhtme:

1. Verifikimi i Besueshmërsisë në praktikën reale

Një teknologji mund të funksionojë në mënyrë të kënaqshme në kushte të kontrolluara studimore, por të shfaqë kufizime të papritura gjatë përdorimit të përditshëm. Përdorimi paraprak në qendra me volum të lartë ofron prova se teknologjia mund të përballojë kërkesat e vazhdueshme të praktikës klinike.

2. Konfirmimi i Integritetit në Rrjedhat Klinike të Punës

Laboratorët universitarë të kardilogjisë invazive funksionojnë brenda proceseve komplekse që përfshijnë PCI emergjente, rrjete STEMI, implantim pajisjesh kardiake, ndërhyrje strukturore, sisteme imazherike, sisteme informacioni spitalor dhe ekipe multidisciplinare. Përdorimi rutinë klinik demonstroi aftësinë e teknologjisë për t'u integruar në mënyrë efektive në këto procese.

3. Validimi përtej kushteve të studimeve klinike

Studimet klinike zakonisht kryhen në qendra të përzgjedhura, me operatorë të trajnuar posaçërisht dhe me pacientë të seleksionuar. Rezultatet e arritura në këto kushte mund të mos reflektojnë plotësisht performancën në praktikën e zakonshme klinike. Adoptimi i gjerë klinik siguron evidencë shtesë për riprodhueshmërinë dhe përgjithësimin e rezultateve.

4. Vlerësimi i performancës afatgjatë

Disa probleme teknike, kufizime programesh, çështje qëndrueshmërie, nevoja për mirëmbajtje apo shqetësime sigurie mund të bëhen të dukshme vetëm pas viteve të përdorimit. Përvoja e dokumentuar pas vendosjes në treg mundëson vlerësimin e performancës afatgjatë përtej fazës fillestare të miratimit.

5. Disponueshmëria e eksperiencës klinike dhe infrastrukturës së trajnimit

Teknologjitë tashmë të implementuara në qendra terciare përfitojnë nga egzistenca e protokolleve të standardizuara, përvoja e operatorëve, programeve të trajnimit dhe shkëmbimit të eksperiencës ndërmjet qendrave, duke lehtësuar përdorimin e sigurt dhe efikas.

6. Verifikimi i kapacitetit të servisit dhe mbështetjes teknike

Përdorimi i suksesshëm në praktikë demonstroi ekzistencën e një infrastrukture të qëndrueshme të mirëmbajtjes, furnizimit me pjesë këmbimi, përditësimeve të programeve dhe mbështetjes teknike nga prodhuesi ose distributori.

7. Ulja e riskut institucional dhe të pacientit

Për teknologjitë që mbështesin procedura jetike, si PCI primare, trajtimi i STEMI, ndërhyrjet strukturore të zemrës dhe implantimi i pajisjeve kardiake, minimizimi i riskut operacional dhe klinik përbën një objektiv legjitim institucional. Evidenca e përdorimit rutinë redukton paqartësinë lidhur me sigurinë, efektivitetin dhe performancën operacionale.

Për të ilustruar faktin se marrja e autorizimit të markës CE dhe autorizimi nga FDA nuk garantojnë mjaftueshëm vlerën e një teknologjie, ju sjellim shembullin e stentit të bioabsorbueshëm të prodhuar nga Abbot (Absorb BSV), i cili mori autorizimin e markës CE në vitin 2011 dhe autorizimin për tregtim nga FDA në vitin 2016 dhe, pas entuziazmit fillestar, rezultatet e studimeve të fokusuara mbi praktikën afatgjatë të përdorimit pas vendosjes në treg, ngritën shqetësime shumë të rëndësishme lidhur me sigurinë e kësaj teknologjie. Kjo u pasqyrua nga ndërprerja e tregtimit rutinë të saj në vitin 2017 dhe eliminimi total i saj prej praktikës klinike të

mëvonshme për shkak të rritjes së papranueshme të numrit të infarkteve të miokardit, trombozave të stentit dhe mbylljeve të arterieve të trajtuara.

1. <https://abbot.mediaroom.com/2015-05-19-Abbott-Announces-CE-Mark-for-New-Advancement-of-Absorb-Stent-System-for-People-with-Heart-Disease>
2. <https://abbot.mediaroom.com/2016-03-15-Abbotts-Absorb-the-First-Fully-Dissolving-Heart-Stent-Earns-Positive-Review-by-FDA-Advisory-Committee>
3. <https://www.tctmd.com/news/fda-warns-risk-major-adverse-cardiac-events-absorb-bvs>
4. <https://www.accessdata.fda.gov/scripts/cdrh/cfdocs/cfres/res.cfm?id=155009>

Në lidhje me pretendimin e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimes, KSHA, pas shqyrtimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit dhe analizimit të përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Kontraktor Përfitues, vlerëson se specifikimi teknik i kontestuar nga ankimesi përbën një kërkesë objektivist të justifikuar dhe të nevojshme për garantimin e sigurisë së pacientëve dhe besueshmërisë së teknologjisë. Autoriteti Kontraktor Përfitues ka argumentuar se edhe pse marka CE dhe miratimi nga FDA konfirmojnë se një pajisje mjekësore plotëson kërkesat rregullatore për tregtim, ato nuk garantojnë vetvetiu sigurinë, besueshmërinë dhe efektivitetin e saj në praktikën klinike të përditshme, veçanërisht në qendra terciare me volum dhe kompleksitet të lartë si QSUT. Për teknologjitë me risk të lartë, si aterektomia rotacionale, është thelbësore të ekzistojë evidencë e përdorimit rutinë në qendra të konsoliduara, që të vërtetojë performancën afatgjatë, integrimin në praktikën klinike, mbështetjen teknike dhe sigurinë për pacientët. Rasti i stentit bioabsorbues Absorb BVS tregon se edhe teknologjitë e miratuara nga CE dhe FDA mund të rezultojnë të papërshtatshme pas përdorimit në praktikën reale, duke theksuar rëndësinë e provave klinike pas vendosjes në treg.

Pra referuar argumentimit teknik rezultojnë se specifikimi teknik, sipas të cilit pajisja duhet të ketë provë të përdorimit të mëparshëm në Kabinete Hemodinamike në shtetet e BE-së dhe/ose SHBA-së (pra të mos jetë pajisje apo software eksperimentale ose në fazë testimi), përbën një kërkesë objektivist të justifikuar dhe të nevojshme për garantimin e sigurisë së pacientëve dhe besueshmërisë së teknologjisë.

Megjithatë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, konstaton se dokumentacioni provues i parashikuar në Dokumentet e Tenderit në lidhje me përmbushjen e këtij specifikimi është i paqartë dhe nuk përcakton në mënyrë të saktë mjetet e provës që duhet të paraqesin Ofertuesit si dhe kriteret mbi të cilat do të vlerësohet përmbushja e tij. Kjo krijon pasiguri dhe konfuzion për Operatorët ekonomik pjesëmarrës jo vetëm në lidhje me dokumentacionin që ata duhet të paraqesin, por gjithashtu edhe për mënyrën se si Autoriteti Kontraktor do të kryejë vlerësimin e këtij specifikimi gjatë fazës së hapjes dhe shqyrtimit të ofertave, duke lënë hapësirë për interpretime subjektive dhe duke cënuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës efektive si dhe sigurisë juridike.

Për këtë arsye, KSHA vlerëson se procedura aktuale e prokurimit ka mangësi të rëndësishme në dokumentet e tenderit, të cilat nuk mund korrigjohen pa cënuar parimet e procedurës.

Në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), Neni 98, pika 1, gërma "c", përcaktohet se: "1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme; b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme; c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme; ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme

dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar; d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.”

Sa më lart cituar, referuar legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, KSHA gjykon se procedura e prokurimit me objekt: *“Blerje Pajisje Mjekësore dhe Materiale Konsumi për Trajtimin Invaziv të Stenozave (Ngushtimeve) të Kalçifikuara të Arterieve Koronare”* duhet të anulohet, si rrjedhojë e mangësive të dokumenteve të tenderit. Gjatë rishpalljes së procedurës së prokurimit objekt ankimi, Njësia e Prokurimit duhet të mbajë në konsideratë mangësitë e konstatuara si dhe të riformulojë qartë kërkesën, duke përcaktuar saktësisht dokumentacionin e nevojshëm provues, si dhe të riorganizojë kriteret e vlerësimit duke parashikuar një sistem vlerësimi me pikëzim, ku eksperiencia e dokumentuar e përdorimit klinik në qendra të konsoliduara të vlerësohet si element cilësor dhe jo si një kriter përjashtues. Një qasje e tillë do të garantonte njëkohësisht konkurrencë më të gjerë, proporcionalitet të kërkesave si dhe përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme mbi bazën e cilësisë dhe performancës së provuar.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “KONEX” shpk dhe propozimin e anulimit të procedurës së prokurimit.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.7. Me shkresën nr. 2391/13 prot., datë 29.06.2026 me lëndë “Dërgim informacioni plotësues pranë Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje mjekësore dhe materiale konsumi për trajtimin invaziv të stenozave (ngushtimeve) të kalçifikuara të arterieve koronare” protokolluar me tonën me nr. 1629/3 prot., datë 01.07.2026 autoriteti kontraktor në kuadër të shqyrtimit të ankesës së sipërcituar të operatorit ekonomik “Konex” SHPK ka vënë në dispozicion të KPP komunikimin shkresor me AK përfitues me nr. 24.06.2026 marrë me nr. 2391/9 prot., datë 26.06.2026.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Konex” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të paraqitura në ankesën me numër A/2026/6713 datë 25.05.2026 dhe nr.1629/2026 prot., datë 25.05.2026, konkretisht duke kërkuar modifikimin e specifikimeve teknike si vijon:

“[...] Për sa më sipër, kërkojmë Heqjen e kriterit:

“Të ketë / kenë provën e përdorimit të mëparshëm në Kabinete Hemodinamike në shtetet e EU dhe / ose USA”

Riformulimin e tij në mënyrë jodiskriminuese dhe në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik. Sugjerojmë formulimin:

“Pajisja duhet të jetë e certifikuar CE sipas MDR 2017/745 ose ekuivalent, të mos jetë pajisje eksperimentale dhe operatori ekonomik të paraqesë dokumentacion teknik që provon sigurinë dhe performancën e saj.” KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 6, “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator

specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet Teknike:

- *Ky objekt prokurimi përfshin dhënien në huapërdorje pranë AK, të një pajisje mjekësore për atherektomi rrotulluese aktive. Specifikimet teknike të pajisjeve janë specifikimet minimale që duhet të plotësojnë këto pajisje. Janë të mirëpritura pajisje me specifikime më të mira. Për pajisjet në përdorim, duhet që:*
 - *Të gjitha pajisjet dhe software përkatës duhet të jenë të certifikuara CE dhe FDA*
 - *Të gjitha pajisjet e mëposhtme mjekësore, pjesët përbërëse dhe aksesoret e tyre duhet të jenë të reja, të prodhuara jo më shumë se 1 (një) vit më parë*
 - *Të gjithë pajisjet duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, manual teknikë, etj*
 - *Për të gjitha pajisjet duhet të kryhen trajnimet përkatëse për përdorimin e tyre.*
 - *Garancia e pajisjeve të jetë jo më pak se 1 (një) vit*

1. Pajisja / Pajisjet për atherektomi rrotulluese aktive

- *Të jetë pajisje e lëvizshme për përdorim për atherektomi rrotulluese aktive e përdorshme për Arteriet Koronare. Sistemi duhet të jetë i përpuethshëm me materialet e konsumit të kërkuara për atherektominë.*
- *Pajisja duhet të përfshijë njësinë e kontrollit, ekranin për monitorimin e shpejtësisë së rrotullimit dhe kohëzgjatjes së ndërhyrjes.*

- Duhet të jetë e pajisur me rrotull komandimi për shpejtësinë rrotulluese të frezes. Portat hyrëse të pajisjes përfshijnë furnizimin me energji nga rrjeti elektrik standart Shqiptar (230V – 50Hz AC) dhe furnizimin me ajër të kompresuar ose Azot (6 – 7 atm).
- Shpejtësia e rrotullimit që mundëson pajisja duhet të jetë 60.000 – 200.000 ose më shumë rrotullime në minutë / RPM.
- Portat dalëse duhet të përfshijnë lidhjen pneumatike me frezën e atherektomisë dhe lidhjet elektronike dhe optike për monitorimin e rrotullimit të frezës.
- Të ketë suport me rrota për montimin e njësisë së kontrollit.
- Të ketë rregullator presioni për lidhje me bombul për gazin e kompresuar ose për lidhjen me rrjetin qëndror të gazeve spitalore.
- Të përfshihen të gjithë konektorët elektrikë dhe pneumatikë të nevojshëm për funksionimin e pajisjes.
- Seti i atherektomisë duhet të disponojë lidhjet e pershtatshme elektrike dhe pneumatike me njësinë e kontrollit të atherektomisë.
- Të ketë / kenë provën e përdorimit të mëparshëm në Kabinete Hemodinamike në shtetet e EU dhe / ose USA (jo pajisje / software eksperimentale ose në testim).
- Të ketë / kenë opsionin e komandimit nga një operator i vetëm (kontrollor freze / modul komandimi në tavolinën e pacientit në Kabinetin e Hemodinamikës).
- **Pajisja do t'i ofrohet QSU "Nënë Tereza" me sistem huazimi përgjatë gjithë periudhës së kontratës. Furnitori merr përsipër riparimin / zëvendësimin e pajisjes në rast difekti / problematike. Furnitori duhet të garantojë suportin teknik dhe mirëmbajtjen në rast difekti / problemi për të mos penguar vijueshmërinë e punës.**
- Furnitori duhet të vlerësojë paraprakisht standartet teknike të kabinetit të Hemodinamikës (lidhjet hidraulike – pneumatike / lidhjet elektrike) dhe të garantojë përputhshmërinë e pajisjes me kabinetin e Hemodinamikës.

2. Frezë me kateter (me një përdorim) për atherektomi rrotulluese aktive.

Set steril me një përdorim që përdoret për atherektomi rrotulluese aktive. Përfshihet freza (Diametër 1.25mm – 2.0mm) me kateter me gjatësi 135 – 150 cm. Seti i atherektomisë duhet të disponojë lidhjet e pershtatshme elektrike dhe pneumatike me njësinë e kontrollit të atherektomisë. Të jetë e pajisur me mekanizëm sigurie për çaktivizimin e rrotullimit në rast keqfunksionimi.

Kontrollori i frezës përfshin dorezën e avancimit, butonin e aktivizimit dhe frenimit.

3. Gidë e pershtatshme për sistemin e atherektomisë aktive rrotulluese së bashku me torquer përkatës

- Guida specifike Atherektomie Rrotulluese me bërthamë Platini.
- Të ofrohet në të dyja opsionet Floppy / Extra Support
- Diametri i majës 0.014inch / kompatibilitet me frezën e atherektomisë rrotulluese aktive
- Të ofrohet me gjatësi $\geq 330\text{cm}$

- Të ofrohet sëbashku me torquer përkatës

4. Mikrokateter

Të ofrohet me:

- Profili i hyrjes: ≤ 1.5 Fr.
- Profili i kalimit: 2.0 – 2.5 Fr.
- Përputhshmëria e gidës: 0.014 inch.
- Markues Distal radio-opak.
- Veshje hidrofilike në ≥ 50 cm distalë.
- Gjatësia e punës: dy opsione, 130 – 140cm dhe 145 – 155 cm.

5. Kateter drejtues për zgjatim

Të ofrohet me:

- Gjatesia e zgjatimit: 20 – 30 cm dhe 35 – 45 cm.
- Gjatesia e punës: 140 – 160cm.
- Marker Distal radio-opak.
- Veshje hidrofilike.
- Të ofrohet në 3 diametra. 6F – 7F – 8F.

6. Balon prerës për lezione të forta

Të ofrohet me:

- Balon me presion të ulët (presion nominal < 8 ATM).
- I pajisur me 3 – 4 pjesë prerëse (Aterotoma) për zgjerimin e lezioneve të forta.
- Gjatësia e kateterit të balonit 100 – 120cm.
- Pajisur me veshje hidrofilike dhe me dy markues.
- I kalueshëm në gidë ≥ 5 F
- Kompatibël me telat (guidewire) standart 0.014 inch

7. Introduktor (sheath) 8F

- Introduktor (sheath) 8F, set komplet që përfshin introduktorin, dilatatorin, gidën dhe agen e punkSIONIT.
- Gjatësi 9 – 40 cm.
- Kompatibël me telat (guidewire) standart 0.035 - 0.038 inch.

8. Kateter gidë 8F

- Kateter gidë 7F - 8F (Kompatibël me procedura atherektomie rrotulluese)
- Gjatësia 80 – 100 cm.

- Majë atraumatike.
- Veshje hidrofilike.
- Të ofrohet me kurbat më të përdorshme (JL / EBU ose ekuivalent / JR / AL & AR) me madhësi të ndryshme kurbe.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PERGJITHESHME

- Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e prodhimit
- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull si dhe kërkesat bazë të vendosjes në treg të pajisjeve mjekësore (për pajisjen në huapërdorje).

¹Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor”, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës

për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.1.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë

apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të

tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për siguri të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin*

dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "*specifikim teknik*" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modeli për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larinë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.*"

Gjithashtu, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar është përafruar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar." Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i

ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non* se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t’i përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Gjithashtu, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Kështu, autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, nuk mund të nisët vetëm nga procedura analoge të zhvilluara më parë nga po i njëjti autoritet kontraktor ose nga autoritete të tjera kontraktore homologe, ose eprore, por në përputhje me parashikimet e ligjit.

III.1.7. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.8. Në procesverbalin për “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e specifikimeve teknike si vijon:

“Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP:

“38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe

arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III.1.9. Lidhur me pretendimet e ankimesit dhe pas verifikimit të përmbajtjes së specifikimeve teknike më sipër objekt ankese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohet nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Në procesverbalin për hartimin e specifikimeve teknike autoriteti kontraktor ka dështuar të argumentojë pse ka kërkuar specifikimin teknik “*Të ketë / kenë provën e përdorimit të mëparshëm në Kabinete Hemodinamike në shtetet e EU dhe / ose USA*). Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike KPP vëren se përveçse pajisja do t’i ofrohet QSU “Nënë Tereza” me sistem huazimi përgjatë gjithë

periudhës së kontratës gjithashtu të gjitha pajisjet dhe software përkatës duhet të jenë të certifikuara CE dhe FDA, dokumentacion tekniko-ligjor ky që ndër të tjerë (por pa u kufizuar vetëm në atë) përbën provë për cilësinë dhe funksionalitetin e pajisjes. Kufizimi i përdorimit në territore gjeografike të caktuara nuk është element provues mbi suksesin e pajisjes dhe nuk është klinikisht i justifikuar pasi në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë pse historiku i përdorimit në rajone gjeografike të caktuara (EU/USA) sjell përfitime klinike të matshme, por përkundrazi në vlerësim të KPP këto kufizime krijojnë pengesa artificiale për subjekte të cilat historikisht nuk kanë operuar në këto tregje por zotërojnë pajisje dhe dokumentacion tekniko-ligjor që përbëjnë garanci për sigurinë dhe performancën e pajisjes. KPP thekson faktin që vërtetë hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë në diskrecion të autoritetit kontraktor por ky diskrecion nuk është i pa kufizuar pasi hartimi i tyre duhet të jetë gjithnjë në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si dhe me legjislacionin sektorial në fuqi si dhe nuk duhet të kufizojnë konkurrencën dhe të orientojnë drejt një prodhuesi të vetëm. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se çdo kërkesë e dokumentave të tenderit e përcakuar nga autoriteti kontraktor në mënyrë të pa argumentuar/justifikuar do të cënonte barazinë, transparencën dhe konkurrencën në radhët e operatorëve ekonomikë duke rënë nëkundërshtim edhe me vetë qëllimin dhe frymën e legjislacionit të prokurimit publik. Në këtë kuadër me qëllim sigurimin e një gare gjithëpërfshirëse dhe rritjen e konkurrencës në radhët e operatorëve ekonomikë autoriteti kontraktor duke qenë se nuk ka arritur të argumentojë specifikimin teknik *“Të ketë / kenë provën e përdorimit të mëparshëm në Kabinete Hemodinamike në shtetet e EU dhe / ose USA)”* duhet të marrë masa për heqjen e tij por pa cënuar pjesën e kërimit *“(jo pajisje / software eksperimentale ose në testim)”* pasi ky i fundit nuk përbën objekt të ankesës, por me qëllim shmangien e konfuzionit në fazën e vlerësimit të ofertave apo në kuadër të rishikimit administrativ të procedurës autoriteti kontraktor duhet të jetë i qartë mbi mënyrën se si operatorët ekonomikë do të provojnë që pajisja/software është jo eksperimentale apo në testim.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. KPP nga shqyrtimi i vendimit të KSHA-së konkretisht *“Vendim K.SHA 104/2026”* datë 26.06.2026, ku ndër të tjera është shprehur se: *“[...] Sa më lart cituar, referuar legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, KSHA gjykon se procedura e prokurimit me objekt “Blerje Pajisje Mjekësore dhe Materiale Konsumi për Trajtimin Invaziv të Stenozave (Ngushtimeve) të Kalçifikuara të Arterieve Koronare”, duhet të anulohet si rrjedhojë e mangësive të dokumenteve të tenderit. Gjatë rishpalljes së procedurës së prokurimit objekt ankimi, Njësia e Prokurimit duhet të mbajë në konsideratë mangësitë e konstatuara si dhe të riformulojë qartë kërkesën, duke përcaktuar saktësisht dokumentacionin e nevojshëm provues si dhe të riorganizojë kriteret e vlerësimit duke parashikuar një sistem vlerësimi me pikëzim, ku eksperiencia e dokumentuar e përdorimit klinik në qendra të konsoliduara të vlerësohet si element cilësor dhe jo si një kriter përjashtues. Një qasje e tillë do të garantonte njëkohësisht konkurrencë më të gjërë, proporcionalitet të kërkesave si dhe përzgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme mbi bazën e cilësisë dhe performancës së provuar.”* vëren se, vendimi i KSHA që me rishpalljen e procedurës Njësia e Prokurimit të

riorganizojë kriteret e vlerësimit duke parashikuar një sistem vlerësimi me pikëzim, ku eksperiencia e dokumentuar e përdorimit klinik në qendra të konsoliduara të vlerësohet si element cilësor dhe jo si një kriter përjashtues, është në tejkalim të kompetencave të tij pasi ligji dhe rregullat e prokurimit publik qartazi kanë përcaktuar detyrat e njësive/organeve përkatëse në kuadër të zhvillimit procedurave të prokurimit publik apo në kuadër të procesit të rishikimit administrativ të tyre. Bazuar në nenin 74 pika 3/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe mbledhja e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre është detyrë e personit përgjegjës për prokurimin dhe njësisë së prokurimit dhe në kuadër të procesit të rishikimit administrativ çdo formë sugjerimi apo orientimi mbi mënyrën e hartimit të kërkesave dhe kriterëve në dokumentet e tenderit shkon përtej kompetencave që ligji dhe rregullat e prokurimit publik i njohin trupës rishikuese të vendimit të njësisë së prokurimit mbi hartimin e kriterëve për kualifikim apo kriterëve për shpalljen e kontratës fituese.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Konex” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-85806-05-15-2026, me objekt: “Blerje Pajisje Mjekësore dhe Materiale Konsumi për Trajtimin Invaziv të Stenozave (Ngushtimeve) të Kalçifikuara të Arterieve Koronare”, me fond limit 45,239,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 17.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe t’i publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Konex” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Gjergj Mersini	Edvin Simo	Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu